



Ministri i Mjedisit, z. Lefter Koka, shpalli 21 Marsin Ditën Botërore të Pyjeve duke mundësuar që Shqipëria t'i bashkangjitet inisiativës së Kombeve të Bashkuara.

Nëpërmjet një letre të drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, z. Ban Ki Moon, Ministri i Mjedisit, z. Koka shprehu konsideratat e tij më të larta për inisiativat e vazhduara që ndërmarrin Kombet e Bashkuara për zhvillimin ekologjik të qëndrueshëm në mbarë botën.

Bërja pjesë e Shqipërisë në këtë inisiativë është një nga elementët e ndërmarrja nga Ministria e Mjedisit, por inisiativa më e rëndësishme dhe që kërkon fonde dhe

përkushtimin e të gjithëve është platforma 3 vjeçare për ripyllëzimin e Shqipërisë.

Kjo platformë që është piketuar nga Ministria e Mjedisit po përkthehet në plane veprimi, si në aspektin ligjor, ashtu edhe në aspektin veprues. Kështu në kuadër të kësaj platforme është parashikuar mbjelljen e 10 milion fidanëve pyjor për vitin 2014-2017.

Kjo mbjellje do realizohet në sipërfaqet e dëmtuara pyjore në ato të djegurat dhe të degraduarat. Kjo ndërmarrje e madhe në fushën e pyjeve do bëhet dhe në bashkëpunim me operatorët privat që kanë detyrim për mbjellje apo pyllëzim, donatorët e ndryshëm që financojnë në fushën e pyjeve dhe zonave të mbrojtura, si dhe me buxhetin e shtetit.

Gjithashtu, në aspektin ligjor, po hartohen aktet nënligjore, të cilat do të ndalojnë plotësisht tjetërsimin e fondit pyjor që shpesh bëhej pre e zjarreve të qëllimshme, për t'u kthyer më pas në toka bujqësore apo kullosore për pronarët.

Në aspektin e inspektimit dhe monitorimit për prerjet e paligjshme, Ministria e Mjedisit, jo vetëm po bashkëpunon me policinë e shtetit dhe inspektoriatet e tjera, por po shikon mundësinë e formave të reja të survejimit të zonave të mbrojtura dhe pyjore në Shqipëri përmes kamerave të sigurisë.

Pra siç shihet, inisiativa për shpalljen e Ditës Botërore të Pyjeve është thjesht pika kulminante e një politike tërësisht të re që po ndërmerrret kundrejt pyjeve në Shqipëri.

## KRIMI MJEDISOR DHE EKSPERIENCA EUROPIANE

Në 18 Mars 2014, Ministria e Mjedisit në bashkëpunim me Projektin SELEA të Bashkimit Europian dhe PAMEKA (*Konsolidimi i Kapaciteteve Ligjzbatuese në Shqipëri*) organizuan Konferencën Ndërkombëtare "Parandalimi i Krimit Mjedisor në Shqipëri". Gjatë kësaj konference u bë një analizë e situatës legjislativë në Shqipëri në lidhje me krimin mjedisor, arritjet dhe mangësitë që vihen re.

Legjislacioni mjedisor në Shqipëri është në dinamikë ndryshimesh që e bëjnë të mundur përputhshmërinë e tij me Direktivat e Bashkimit Europian dhe në elementët e kërkuara për identifikimin dhe ndërshkrimin e dëmeve mjedisore. Ndryshe qëndron situata për legjislacionin penal në Shqipëri, i cili daton në vitin 1995 dhe e bën

atë të ketë mangësi të theksuar në lidhje me direktivën e BE 2008/99/EC mbi mbrojtjen e Mjedisit përmes legjislationit penal. Legjislacioni aktual nuk bën dallimin qartë midis shkeljeve civile dhe veprave penale.

Gjithashtu shoqëria Shqiptare vuan dhe nga zbatimi i dobët i legjislationit gjë që e bën dyfish më të vështirë dënimin e krimit mjedisor.

Mjaft e rëndësishme në këtë Konferencë ishte sjellja e eksperiencës Italiane, në fushën e krimit mjedisor duke analizuar situatat konkrete të sjella si nga zëvendës/Prokurori i Zyrës së Prokurorisë së Napolit z. Domenico Airoma, po ashtu dhe eksperiencia e sjellë nga trafikimi i paligjshëm i mbetjeve sjellë nga

oficeri i policisë gjyqësore të Italisë z. Paskuale Strace.

Një prezantim mjaft interesant duke ofruar bashkëpunim ishte dhe prezantimi për njësinë e Sigurimit INTERPOL, që kishin si fokus dhe mjedisin, prezantuar nga znj. Thereza Shryan, nëndrejtoreshë e Sigurimit Mjedisor Interpol.

Disa nga arritjet e kësaj Konference ishin (i)identifikimi i problematikave në Shqipëri në fushën e krimit mjedisor, (ii)eksperiencia e sjellë ilustruar dhe me raste konkrete nga shteti fqinj Italia dhe së fundmi (iii)konkluzione se për të luftuar krimin mjedisor kërkohet një bashkëpunim mjaft i madh ndërmjet inspektoriateve të Mjedisit, prokurorisë dhe policisë së Shtetit.

### NË KËTË NUMËR:

21 MARS -DITA BOTËRORE E PYJEVE

Fq. 1

KRIMI MJEDISOR DHE EKSPERIENCA EUROPIANE

Fq. 1

Fq. 3

LEJET MJEDISORE - JANAR 2014

Fq. 4

RUBRIKA NJOFTIME

"Misioni i Ministrisë së Mjedisit, është të hartojë dhe propozojë politika, strategji dhe plane veprimi për mbrojtjen dhe administrimin e mjedisit, pyjeve dhe ujërave në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm, përmirësimit të cilësisë së jetës dhe të integritetit të vendit në Bashkimin Europian. Përmes kësaj misioni do të realizohet duke marrë pjesë, nxitur dhe bashkëpunuar veprimtaritë, të cilat çojnë në zhvillime e mirëqenie afatgjata, duke mbrojtur natyrën dhe sensibilizuar opinionin publik".

## LEJET MJEDISORE JANAR 2014

Nr	Subjekti	Aktiviteti	Vendodhja	Vendimi
1	BETON VLORA 2013	Linjë fraksionimi për inerte	Drashovicë, Vlorë	Refuzohet
2	RAYSPELLET	III 2 B Prodhim peletash	Durrës	Miratohet
3	FLU TO NE	Shfrytëzim ranori pllakorë	Gjirokastrë	Miratohet
4	VELLAZERIA MINERALS ALBANIA	Shfrytëzim minerali i kromit	Zogaj, Kukës	Miratohet
5	MINING FERRO NIKEL	Shfrytëzim minerali nikel-silikat, përpunim, riciklim të mbetjeve minerare	Librazhd, Elbasan	Miratohet
6	GLOBAL SECURITY	Antena	Tiranë	Miratohet
7	SHELQETI COMPANY & BESIM ISUFAJ	Grumbullim, përpunim paketim tregëtim duhani	Shkodër	Miratohet
8	XHUVI SHARXHI	Godinë banimi	Sauk, Tiranë	Shtyhet
9	BARDHI	III 2 B Grumbullim mbetjesh	Laç, Lezhë	Miratohet
10	EDLA	Shfrytëzim minerali i kromit	Iballë, Shkodër	Shtyhet
11	FABRIKA E PASURIMIT TË KROMIT BULQIZË	Nxjerrje e mineralit të kromit	Iballë, Shkodër	Refuzohet

Nr	Subjekti	Aktiviteti	Vendodhja	Vendimi
1	DRINI-A	Pastrim, thellim, disiplinim i shtratit të lumit Drin	Bahçallëk Bërdicë Shkodër	Refuzohet
2	SCHOLZ	Impiant për riciklimin e metalit për skrap	Xhafzotaj Durrës	Miratohet
3	SCHOLZ III.2.B	Impiant për riciklimin e metalit për skrap	Xhafzotaj Durrës	Miratohet
4	FATLUM	Ndërtim HEC	Has Kukës	Miratohet
5	BAHITI PLAST	Grumbullim, transportim, riciklim mbetjesh plastike	Porto Romano Durrës	Miratohet
6	GAVRAN ENERGY 1	Ndërtim me konçesion HEC	Librazhd Elbasan	Miratohet
7	GAVRAN ENERGY	Ndërtim me konçesion HEC	Librazhd Elbasan	Miratohet

Nr	Subjekti	Aktiviteti	Vendodhja	Vendimi
1	Becycle	III.2.B. Grumbullim, transportim mbetje të ngurta e të lëngëta	Otlakë, Berat	Refuzohet
2	Erniku	Fraksionim inertesh, prodhim betoni, asfalto -betoni	Gjorm, Lezhë	Miratohet
3	Elite Mine	Kërkim - zbulim rëre bituminoze	Selenice, Vlorë	Miratohet
4	Kastriot Bardhi	Riveshje gomash të përdorura	Fushë - Krujë, Durrës	Miratohet
5	Skraqi	Fabrike mielli	Elbasan	Miratohet
6	Am Oil	Prodhim, përpunim, magazinim, transportim naftë e nënprodukte të saj	Lushnje	Refuzohet
7	O.L.I.A.	Shfrytëzim kromi	Pishkash, Librazhd	Miratohet
8	HEC Bistrica (Kurum International)	HEC - Transferim leje	Delvinë, Vlorë	Miratohet
9	HEC Ulëz Shkopet (Kurum International)	HEC - Transferim leje	Burrel, Dibër	Miratohet
10	HEC Ulëz Shkopet (Kurum International)	HEC - Transferim leje	Burrel, Dibër	Miratohet

**VENDORËT PËR NJË MENAXHIM MË TË MIRË TË MBETJEVE TË TERRITORIT QË DREJTOJNË**

Vetëm disa ditë më parë Ministri i Mjedisit nëpërmjet një letre të personalizuar për çdo kryetar komune dhe bashkie kërkoi prej tyre respektimin e ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” si dhe Ligjin “Për Menaxhimin e Integruar të mbetjeve”, ligje që i bëjnë ata autoritetin përgjegjës për menaxhimin e mbetjeve në territorin që drejtojnë.

Në përgjigje të kësaj letre ka filluar veprimet komuna Dajç, Lezhë me kryetar z. Gjergj Doçi, i cili informon për punën e bërë në fushën e mbetjeve në këtë komunë. Ai shpjegon se mbetjet

mblidhen në mënyrë të vazhduar gjatë javës dhe mbetjet e mbledhura depozitohen në vendepozitim të mbetjeve në Bushat.

Gjithashtu kjo komunë sjell eksperiencën e bashkëpunimit me një shoqatë mjedisore, e cila ka mundësuar blerjen e kazanëve dhe sensibilizimin e banorëve për t'i depozituar mbetjet e tyre në to.

Eksperienca pozitive në menaxhimin e mbetjeve ka në shumë komuna të Shqipërisë, por shqetësimi i Ministrisë të Mjedisit është që kjo eksperiencë në disa rrethe, të bëhet pjesë e çdo komune dhe banori të vendit tonë.



**VAZHDON PASTRIMI PËR SEZONIN TURISTIK**

Në 22 Mars Ministria e Mjedisit, ju bashkua Korpust të vullnetarëve për të pastruar plazhin e gjithit të Lalëzit. Ministri i Mjedisit z. Koka, nga ky aksion ku marrin pjesë shumë të rinj e të reja dhe si mesazh që të gjithë banorët të rinj dhe të reja që jetojnë pranë plazheve, duhet t’i kujdesen për t’i pastruar dhe mirëmbajtur ato për të pasur një sezon turistik cilësor.

Pastrimi do të vazhdojë dhe në zonat e tjera bregdetare.

## LEJET MJEDISORE JANAR 2014

Nr	Subjekti	Aktiviteti	Vendodhja	Vendimi
1	LA - OR	Shfrytëzim inertesh, lumi Devoll	Shushicë Elbasan	Miratohet
2	Alba Recycling	Grumbullim, sistemim, ambalazhim dhe eksportim vajrash të përdorura si dhe mbetje të materialve alumini, bakër, hekur dhe plastik	Kashar, Tiranë	Refuzohet
3	Alba Recycling	Grumbullim, sistemim, ambalazhim dhe eksportim vajrash të përdorura si dhe mbetje të materialve alumini, bakër, hekur dhe plastik III.2.B	Kashar, Tiranë	Refuzohet
4	Fatmir Alla	Prodhim gëlqere me proces pjekje guri	Noje, Krujë Durrës	Refuzohet
5	Hazbiu F	Shfrytëzim i gëlqerorëve pllakorë	Ura Vajgurore, Komuna Blerim,	Miratohet
6	Sarakraft	Ndërtim dhe funksionim HEC	Pukë, Shkodër	Miratohet

Nr	Subjekti	Aktiviteti	Vendodhja	Vendimi
1	DHOKSA	Akuakulture intensive detare	Xarre, Sarandë, Vlorë	Refuzohet
2	ENERGJI UNIVERS	HEC Kabash - Pukë	Kabash, Pukë	Miratohet
3	MUSTAFARAJ	Impiant industrializim uji	Uji i Ftohtë Vlorë	Miratohet
4	ROFIX	Fabrikë e prodhimit të llacit	Tapizë, Nikël, Durrës	Refuzohet
5	GEGA - G	Shfrytëzim i gurit gëlqerorë	Dardhë, Elbasan	Miratohet
6	SHEHU	Impiant i thyerjes së gurit gëlqerorë	Sherishtë, Qendër-Vlorë	Miratohet
7	VLLAZNIMI DEDA IMPORT EXPORT	Shfrytëzim karriere për prodhim minerali kromi	Komuna Surroj Kukës	Miratohet

### SHUMICA E HEC-EVE PA LEJE MJEDISORE



Inspektoriat i Mjedisit po ushtron kontroll ditët e fundit mbi të gjitha subjektet që kanë marrë leje nga Ministria e energjitikës për ndërtimin e


HEC në Shqipëri.

Nga kontrolli i ushtruar rezulton se nga rreth 450 HEC-ce që kanë marrë lejen nga Ministria e Energjitikës vetëm 189 prej tyre kanë marrë dhe lejen mjedisore.

Siç shihet pjesa më e madhe e këtyre aktivitetëve nuk ka aplikuar për leje mjedisore. Gjithashtu që këto aktivite-

te janë në zona të mbrojtura, gjë që sjell një dëm të pallogaritshëm në mjedis.

“Propozimet tona për vendosjen e gjobave do jenë maksimale për të gjithë ata që kanë ushtruar këtë aktivitet pa pasur leje mjedisore—theksoi, z. Ergys Agasi Drejtori i Kontrollit në Mjedis, gjatë ushtrimit të inspektimit të tij në disa rrethe të vendit .



[www.mjedisi.gov.al](http://www.mjedisi.gov.al)

## THËNIA E MUAJIT

*“Aktivist nuk është njeriu që thotë lumi është i ndotur, është njeriu që e pastron atë”.*

*Ross Perot*

SEKTORI I TRANSPARENCËS DHE KOMUNIKIMIT

Email: [info@moe.gov.al](mailto:info@moe.gov.al)

## RUBRIKA NJOFTIME

Ministria e Mjedisit fton personat e interesuar të marrin pjesë dhe të konkurojnë për të përfituar certifikatën e ekspertit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe Auditimit Mjedisor, bazuar në Udhëzimin Nr. 1, datë 22.02.2011 “Për Përcaktimin e programeve dhe procedurave të zhvillimit dhe të vlerësimit të provimeve për pajisjen me certifikatën e specialistit për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor.

Kërkesa të përgjithshme:

- Kërkesën për pajisjen me certifikatë si dhe mënyrat e kontaktimit (telefon, e-mail, etj.);
- Diplomën e noterizuar dhe listën e notave;
- Dëshmi të kualifikime;
- CV, ku veç të tjerave, provohet diplomimi dhe përvoja e punës në fushën e mjedisit, jo më pak se pesë vjet;
- Informacion për eksperiencën në projekte për mbrojtjen e mjedisit;
- Faturën e tarifës së shërbimit prej 10000 (dhjetë mijë) lekë, që paguhet për llogari të Ministrisë së Mjedisit dhe që është e pakthyeshme;

Të drejtën për të aplikuar për ekspert të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe Auditimit Mjedisor e kanë specialistët e diplomuar në fushën e mjedisit ose të agromjedisit, në Universitetin Politeknik të Tiranës, në Universitetin Bujqësor të Tiranës, në universitetet ose shkollat e larta jopublike, të akredituara për degët e sipërpërmendura ose në institucionet e huaja të arsimit të lartë që ofrojnë këto programe studimi, pas njësimit të diplomës së tyre, si dhe specialistët e diplomuar në shkencat inxhinierike, biologjike, kimike, gjeologjike, hidrologjike, ekonomike dhe gjeografike.

Personat e interesuar të dorëzojnë dokumentat e sipërcituara brenda datës 15.04.2014 në adresën: Ministria e Mjedisit, Rruga e Durrësit, Nr. 27, Tiranë.